



Npi – 01/129 datë: 03.04.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 7, 8, 10 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04/L-071; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi listën e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve Npi – 01/45 datë: 12.02.2025, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komisionit Npi-01/60 të datës 13.03.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 03.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË SEVDAIR HAXHIU

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 03.04.2025, me shumicën e votave vendosi të REFUZOJË Kërkesën Nr: 06-350/02-28896/24 datë: 31.10.2024, të Sevdair Haxhiu nga fshati Rashincë, për ndrrimin e emërimit të rrugës “Ibrahim Kodra” në fshatin Rashinc me emrin e ri “Zek Haxhiu”.

II

Kërkesa: z.Sevdair Haxhiu, Rr. “Ibrahim Kodra” Nr.18 Rashincë, Kërkesa Nr: 06-350/02-28896/24 datë:31.10.2024, ka kërkuar ndrrimin e emërimit të rrugës “Ibrahim Kodra” në fshatin Rashinc me emrin e ri “Zek Haxhiu”. Emri i propozuar i përket familjarëve të palës. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë peticion ose nënshkrime të banorëve të lagjes. Arsyeimi për emërtimin e kësaj rruge është dhënë se ky emër i propozuar është i familjes tonë, dhe ky vëlla na ka vdekur në vitin 1979 në moshën 24 vjeçare. Më tej pala ka shkruar se jemi të bindur se banorët e lagjes tonë nuk paraqesin ankes në rast të ndërrimit të emrit.

III

- Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes në mbledhjen e -III- të mbajtur më 06.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandoi Kuvendit, Refuzimin e kërkesës me numër Nr:06-350/02-0028896/24 datë: 31.10.2024 të z.Sevdair Haxhiu, nga fshati Rashincë.
- Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen më datën 01.04.2025 miratoi Rekomandimin, Npi – 01/118, me të cilin Kuvendit të Komunës i Rekomandon Refuzimin e kësaj kërkesë.
- Duke marrë parasysh të gjitha këto Kuvendi mori vendim sikurse në Dispozitiv.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi